

Çfarë mund të bëj?

Ka shumë shërbime në dispozicion për t'ju ndihmuar të merrni përkrahje dhe ndihmë, si streha, spitale, policia, shërbime ligjore, dhe shërbime të komunitetit.

A duhet të telefonoj policinë?

Dhuna shtëpiake është krim..

Nëse jeni në rrezik të menjëhershëm, dilni dhe kërkoni ndihmë. Nëse jeni në rrezik, por nuk mund të ikni, telefononi 911. Nëse nuk jeni në gjendje të kontaktoni policinë, telefononi strehën lokale të dhunës shtëpiake.

Në kontenë Macomb, linja në rast krize është: (586) 463-6990.

Në kontenë Oakland, linja në rast krize është: (248) 334-1274.

Për kontetë Oakland dhe Macomb, telefononi Lakeshore Legal Aid's LGBT Projekti i Dhunës Shtëpiake në (586) 469-6522.

A duhet të largohem nga shtëpia nëse jam në rrezik?

Po.. Shkoni në shtëpinë e një miku ose në strehën për gra të abuzuara. Qëndrimi nëpër streha është zakonisht falas dhe atje do të ketë avokatë, të cilët do t'ju ndihmojnë për të vendosur se çfarë do të bëni më pas. Ata do të kenë edhe informacionin e duhur për shërbimet e komunitetit që mund t'ju ndihmojnë. Mbajeni të fshehtë vendndodhjen tuaj.

Po nëse mendoj se më duhet të largohem në të ardhmen?

Bëni një plan për tu larguar. Përgatitni një çantë të vogël me dokumentat e rëndësishme në të (ose së paku kopjet e dokumentave të tilla). Fshiheni këtë

çantë në një vend të sigurt (ndoshta tek një mik) prej nga ku mund ta merrni shpejt.

Mund të dëshëroni të telefononi një linjë telefonike për agjenci dhune shtëpiake dhe kërkoni atyre t'ju ndihmojnë të bëni një plan largimi.

Çfarë duhet të marr me vete?

Bëni çdo përpjekje për të marrë fëmijët tuaj me vete. Është e dobishme nëse mund të sillni me vete dokumentat dhe informacionin e rëndësishëm, të tilla si:

- | | |
|---|--|
| * Patenta e shoferit | * Çertifikata e Martesës |
| * Kontrata qiraje dhe informacion për pronësinë e apartamentit, shtëpisë dhe makinës suaj. | * Informacion çekingu dhe bankar |
| * Çertifikata lindje për veten dhe fëmijët tuaj | * Fletët e fundit të pagesës së rrogës (tuajat dhe të abuzuesit) |
| * Raporte mjekësore dhe të policisë | * Dokumente të asistencës publike |
| * Karta të sigurimit social, viza, dhe green karta apo dokumente imigracioni dhe pasaporta për veten dhe fëmijët tuaj | * Emri, numri i telefonit adresa e ndokujt që e ka apo të cilit i keni folur mbi dhunën e abuzuesit. |
| * Kopje të green kartës apo kartës së imigracionit, kartës së sigurimit social, pasaportës dhe certifikatës së lindjes së abuzuesit | * Rroba apo sende të tjera të dëmtuara si pasojë e dhunës së abuzuesit. |
| * Fotografi të ndonjë dëmi apo dëmtimi të shkaktuara nga abuzuesi juaj | * Mësoni përmendësh numrat telefonikë (psh.Spital, streha, miq, familje) |

Kam dëgjuar për Urdhëra të Mbrojtjes Personale. Çfarë bëjnë ato?

Një Urdhër i Mbrojtjes Personale (UMP) mund të ndalojë abuzuesin t'ju telefonojë, kontaktojë, apo sulmojë ju, fëmijët, ose anëtarë të tjerë të familjes tuaj.

Ligji i Michigan-it kërkon vetëm provë të marrëdhënies midis viktimës dhe abuzuesit pavarësisht nga raca, orientimi seksual apo klasa shoqërore ekonomike.

Mund të fitoni kujdestari të përkohshme të fëmijëve, të merrni përkrahje ekonomike, dhe të largoni abuzuesin nga shtëpia juaj.

Nuk ka nevojë të jeni Qytetar/e i/e SH.B.A-së ose të jeni Banor i Përhershëm i Ligjshëm për të patur një Urdhër Mbrojtjeje.

Si do ta mbështes veten dhe fëmijët e mi nëse do të largohem nga shtëpia?

Si pjesë e urdhërit të mbrojtjes, abuzuesi mund të detyrohet t'ju paguajë para çdo muaj për të mbështetur ju dhe fëmijët tuaj.

Një avokat mund t'ju ndihmojë të gjeni strehim të sigurt dhe ushqim në rast nevoje. Disa mund t'ju ndihmojnë madje të aplikoni për mbështetje publike ose të gjeni punë. Një avokat mund t'ju ndihmojë me nevojat tuaja të tjera duke ju vënë në kontakt me kompani që ofrojnë shërbime ligjore, shoqërore apo mjekësore.

Po nëse jam banor i ligjshëm ose refugjat?

Nëse jeni Banor i Përhershëm i Ligjshëm ose Refugjat/Azilant, statusi juaj i imigrimit nuk do të ndikohet nga ndarja ose divorci me abuzuesin tuaj. Ju

keni status ligjor; abuzuesi juaj nuk ka fuqi mbi INS që t'ju deportojë.

Çfarë është dhuna shtëpiake?

"**Dhuna Shtëpiake**" është dhunë që zakonisht ndodh midis njerëzve të cilët::

* Kanë aktualisht, ose kanë patur një marrëdhënie të rëndësishme

* Jetojnë aktualisht, ose kanë jetuar, së bashku ose kanë lidhje gjaku.

Megjithëse dhuna shfaqet shpesh në formën e dëmtimeve fizike, ajo mund të shfaqet edhe në formën e kërcënimeve, izolimit, keqtrajtimit emocional, abuzimit gojor, ose seksit të detyruar.

Nëse po vuani nga dhuna shtëpiake në shtëpinë tuaj, nuk jeni vetëm. Megjithëse dhuna shtëpiake është zakonisht e fshehur, ajo është tepër e shpeshtë dhe ka të ngjarë që prek shumë njerëz që njihni.

Dhuna Shtëpiake ndodh në të gjitha llojet e marrëdhënieve pavarësisht nga raca, origjina kombëtare, orientimi seksual, apo gjendja shoqërore ekonomike.

Kjo broshurë u bë e mundur në sajë të një dhurate nga Community Foundation for Southeastern Michigan – Fondacioni i Komunitetit për Michiganin Juglindor, Hope Fund Grant që iu dhurua Lakeshore Legal Aid – Ndhima Ligjore e Lakeshore në 2004.

The Community Foundation for Southeastern Michigan – Fondacioni i Komunitetit për Michiganin Juglindor, u krijua në vitin 1984, është një dhuratë afatgjatë e komunitetit e ngritur nga dhurata prej qindra individësh dhe organizatash të përkushtuara ndaj të ardhmes së Michiganit juglindor.

Fondacioni punon të përmirësojë cilësinë e jetës në Michiganin juglindor duke mbështetur një gamë të gjerë aktiviteteve, që u sjellin përfitime edukimit, arteve dhe kulturës, shëndetësisë, shërbimeve njerëzore, zhvillimit të komunitetit dhe çështjeve qytetare.

Sponsorizimi për LAKESHORE LEGAL AID – NDIHMA LIGJORE E LAKESHORE jepet nga United Way, Michigan Bar Foundation, St. Clair County Citizen Millage, dhe neni i shteti federal Older Americans dhe fondet e Duhanit nga Agjencia Lokale mbi Plakjen 1-B dhe Agjencia Lokale mbi Plakjen VII, State of Michigan's Office of Services to the Aging – Zyra e Shtetit të Michiganit për Plakjen, Krahina VII Agjencia Lokale mbi Plakjen; Agjencia Lokale mbi Plakjen, 1-B; dhe organizata të tjera përkrahëse në komunitet.

LAKESHORE LEGAL AID – NDIHMA LIGJORE E LAKESHORE zbaton Federal Civil Rights Act – Nenin e Të Drejtave Civile Federale të vitit 1964, Elliot-Larson Civil Rights Act – Nenin e Të Drejtave Civile Elliot-Larson (P.A. 453 të vitit 1976), Michigan Handicappers Civil Rights Act – Nenin e Të Drejtave Civile të Invalidëve të Michiganit të vitit 1964 siç u vu në fuqi në paragrafin 504 të Social Rehabilitation Act – Nenit të Riaftësisimit Shoqëror të vitit

1973 (Paragrafi 504).

PYETJE DHE PËRGJIGJE **PËR MBIJETUESIT E** **LGBT DHUNA NGA NJË** **PARTNER I AFËRM**

TELEFONONI:

**LAKESHORE LEGAL AID
CENTRAL INTAKE**

TELEFONONI FALAS: 1-888-783-8190

MACOMB OFFICE

21885 Dunham Road, Ste. 4
Clinton Township, MI 48036
(586) 469-6522

ST. CLAIR COUNTY OFFICE
803 Tenth Avenue, Ste. C
Port Huron, MI 48060
(810) 985-5107

